



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2367/1 Prot.

Tiranë, më 18.11.2024

VENDIM

Nr. 29, datë 18.11.2024

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, _____ përfaqësuar nga administratori z. _____ (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2367 Prot., datë 07.11.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 19.07.2024, depozituar nëpërmjet shërbimit postar datë 20.07.2024, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni, sipas shkresës bashkëlidhur, lidhur me:

1. Dokumentacionin zyrtar më të cilin është bërë konfiskimi i sigurimit të ofertës së OE IT Gjergji kompjuter.
2. Referuar dispozitës ligjore të nenit 30 të pikës 7 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, raportimin që kanë bërë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik mbi tërheqjen e operatorit ekonomik IT Gjergji Kompjuter, në të cilën përcaktohet se: Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstatoi se, ankesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën 2, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, (në vijim “LDI”), i cili parashikon se:

“1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. ...”.

Konkretisht, konstatohet se, kërkesa për informacion drejtuar Autoritetit Publik mban datën 19.07.2024, ndërkohë, që ankesa ndaj këtij të fundit drejtuar Zyrës së Komisionerit është në datën 07.11.2024.

Në këto kushte, ankesa ndaj Autoritetit Publik rezulton e depozituar përtej afatit ligjor të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën ‘a’, ‘i’ të pikës 5 të nenit 24, ku citohet se: “5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos: a) mospranimin e ankesës kur: i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;...” dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 2367 Prot., datë 07.11.2024 të _____, përfaqësuar nga administratori z. _____ kundër Autoritetit Publik/Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Kundër këtij vendimi pala ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 18.11.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi